



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1665/prot.

1

Tiranë më 24.12.2020

Lënda: Mendim mbi një projektvendim

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT

KRYEMINISTRIA

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.6323/1 Prot., datë 22.12.2020, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin "*Për rregullat e përdorimit, administrimit dhe ruajtjes së bazës së të dhënave për pasuritë e paluajtshme, si dhe për miratimin e listës së subjekteve që kanë të drejtën e aksesit në sistemin elektronik të të dhënave*", Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, vlerëson se në tërësi projektvendimi është i hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Megjithatë, me qëllim garantimin e parimeve të parashikuara në ligjin nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" (në vijim "*ligji për mbrojtjen e të dhënave personale*"), sugjerojmë që pas pikës 13, të pjesës III të projektvendimit, të shtohet një pikë tjetër me këtë përmbajtje: "*Aksesi i institucioneve sipas pikës 13 dhe Aneksit 1, përcaktohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit specifik që rregullon veprimtarinë, të drejtat dhe detyrimet e këtyre institucioneve. Sasia dhe kategoria e të dhënave personale që aksesohen, duhet të jetë në përputhje me qëllimin e përpunimit sipas legjislacionit specifik.*"

Paragrafi i mësipërm është i rëndësishëm, pasi çdo institucion, në cilësinë e kontrolluesit në kuptim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, legjitimohet të aksesojë të dhëna personale, vetëm për aq sa lidhet me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së tyre. Nga ana tjetër, për përmbushjen e këtij kriteri të ligjshëm përpunimi, është e nevojshme që sistemi të

ndërtohet në mënyrë të tillë që të garantohet akses i kufizuar në përputhje me qëllimin e
përpunimit si dhe gjurmueshmëria për çdo ndërhyrje nga këto institucione.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

